| **Buletini Nr. 36/ 2023, 05-02-2023** | **Parashikimi** nga 05-02-2023, ora 12:00 deri më 06-02-2023, ora 23:59. |
|---|---|

## DËBORA DHE NGRICA

-----------------------------

Sot (e diel, dt. 05) dhe nesër (e hënë, dt. 06) reshjet e dëborës pritet të përfshijnë zonat Verilindore të territorit. Reshjet e dëborës të pasuara nga ulja e ndjeshme e temperaturave dhe ngricat mund të krijojnë probleme të ndryshme dhe vështirësi në transportin rrugor.

## PARASHIKIMI METEO

---------------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e diel, dt. 05) dhe nesër (e hënë, dt. 06) priten reshje të dobëta në qarqet Shkodër dhe Kukës, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje lokale të dobëta dhe nuk ka reshje (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në Verilindje të vendit reshjet pritet të jenë në formën e dëborës, të cilat zbresin deri në lartësinë 400m mbi nivelin e detit.

### TEMPERATURAT

Nesër (e hënë, dt. 06) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet:  -1 / 5 °C
në vendet e ulëta: -4 / 5 °C
në vendet malore: -11 / -4 °C

### ERA

Sot pasdite (e diel, dt. 05) dhe nesër (e hënë, dt. 06) era pritet të fryjë mesatare, ndërsa në bregdet dhe në zonat malore deri e fortë.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LARTË** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | të dobëta | | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | të dobëta | | | | |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | | | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | | | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | të dobëta | | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | të dobëta | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | të dobëta | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | | | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | nuk ka reshje | | | | | |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
|  | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
|  | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
|  | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
|  | Rrëshqitje toke |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 05-06.***